



Pranuar / Dorezuar Prilidheni/Predato Received/Delivered	31-03-2023	3	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS-HIC/3241	2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.372/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.372/2023 të datës 20.02.2023 të parashtruar nga ankuesi rr "Skenderbeu" p.n Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.03.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.372/2023 e datës 20.02.2023 e parashtruar nga ankuesi.

### A r s y e t i m

Nëpunësi Civil i punësuar në pozitën Zyrtar i Projekteve për Rrugë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 20.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1879/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokoli 2107/2023. Ndërsa Këshilli, me datë 09.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë legjislacionin përkatës që rregullon këtë natyrë të kësaj çështje, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pozitën e punës "Zyrtar i Projekteve për Rrugë" ndërsa ankuesi në ankesën e tij pretendon se i takon shtesa mbi pagën bazë për shkak të performancës në punë bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe nenit 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) NR. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik,

Ndërlidhur me këtë çështje Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit e datës 20.02.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me ankesën e ankuesit të datës 20.02.2023 ende nuk kishte vendosur apo nuk ka nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesi të parashtroj ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka pasur afat kohor 45 (katërdhjetë e pesë ditë), për trajtimin e kërkesës së ankuesit të datës 08.02.2023, ndërsa ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 20.02.2023 apo 12 (dymbëdhjetë) ditë pas parashtrimin të ankesës në institucionin punëdhënës në këtë rast Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimi de Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.02.2023 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji."


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.372/2023, datë 31/03/2023

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

